

VENDIM
Nr.320, datë 18.4.2020

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS ME OBJEKT “BLERJE BARNA PROPOFOL 10
MG/ML – 50 ML FLAKON” PËR LOTIN 9, TË PROCEDURËS ME OBJEKT
“BLERJE BARNA KUNDËR CORONAVIRUS COVID – 19, NDARË NË 10 LOTE
(NJË BAR NJË LOT)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe në zbatim të pikës 1, të kreut VII, të vendimit nr.203, datë 26.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e kontratës me objekt “Blerje barna Propofol 10 mg/ml – 50 ml Flakon”, ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe operatorit ekonomik “REJSI FARMA”, sh.p.k., për lotin 9, të procedurës me objekt “Blerje barna kundër Coronavirus COVID–19, ndarë në 10 lote (një bar një lot)”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama